



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë Shanghai Muchuan Industrial Design Co.,Ltd nga shoqëria CARIAD Estonia AS.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.206 prot., i AK, datë 27.03.2023, “Përqendrimi ndërmjet CARIAD Estonia AS / Shanghai Muchuan Industrial Design Co.,Ltd.”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim të kontrollit të shoqërisë Shanghai Muchuan Industrial Design Co.,Ltd, nga shoqëria CARIAD Estonia AS.

Referuar “Marrëveshje shit-blerje kuotash”, palët në marrëveshje janë:

Blerësi: CARIAD Estonia AS, është një shoqëri publike e kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Estonisë. CARIAD Estonia AS, është një nga qendrat ndërkombëtare për kompaninë e softuerit të automobilave CARIAD të Grupit Volkswagen.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij, Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Shitësi 1: Z.Wenxin Zhang , person fizik, banues në Republikën Popullore të Kinës.

Shitësi 2: Z. Xinlei Wang, person fizik, banues në Republikën Popullore të Kinës.

Shitësi 3: Z. Lei Teng, person fizik, banues në Republikën Popullore të Kinës.

Shitësi 4: Shenzhen Hongtai Growth Entrepreneur Investment LLP, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Republikës Popullore të Kinës, ortakëri me përgjegjësi të kufizuar.

Shitësi 5: Shanghai Zhoudao Intelligent Technology LLP, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Republikës Popullore të Kinës, ortakëri me përgjegjësi të kufizuar.

Shitësi 6: Beijing Zcool Network Technology Co., Ltd., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Professional Regulation Commission (PRC).

Shitësi 7: Shenzhen Runyuan Investment LLP, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Republikës Popullore të Kinës, ortakëri me përgjegjësi të kufizuar.

Shitësi 8: Fujian Biaorun Investment LLP, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Republikës Popullore të Kinës, ortakëri me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria Target: Shanghai Muchuan Industrial Design Co.,Ltd., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas legjislacionit Republikës Popullore të Kinës, me objekt aktiviteti: Angazhim në zhvillimin e teknologjisë, transferimin e teknologjisë, këshillimin e teknologjisë dhe shërbimet teknologjike në fushat e teknologjisë së dizajnit industrial, shitje të pajisjeve inteligjente, produkte dixhitale, produkte elektronike, kompjuter, softuer dhe pajisje kompjuterike, etj.

Shoqëria Target nuk është e pranishme dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.